



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**DREJTORIA EKONOMIKE DHE CESHTJEVE SOCIALE**  
**SEKTORI I SHERBIMIT SOCIAL**

Nr. 260 prot.

Ballsh, më 19.01.2024

**PROJEKT- VENDIM**

Nr 01, datë 19/01 /2024

**PER MIRATIMIN KRITEREVE PER FAMILJET NE NEVOJE QE DO TRAJTOHEN ME NDIHME EKONOMIKE DERI NE 6 % TE FONDIT TE KUSHTEZUAR PER BLOK-NDIHMEN ME FONDET E PUSHTETIT QENDROR DHE VENDOR PER VITIN 2024.**

**KESHILLIT TE BASHKISE MALLAKASTER**

Ne mbeshtetje te Ligjin nr. 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9936 date 26/06/2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, Ligjin Nr 109/2017, Ligjit Nr 57/2019 "Per asistencen sociale ne Republiken e Shqiperise", Neni 21 "Roli i Keshillit Bashkiak", VKM Nr. 597 date 04/09/2019 "Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore e perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike", Kapitulli IV "Perdorimi i fondit shtese mbi fondia e kushtezuar per ndihmen ekonomike" : VKM.Nr 868, date 29/12/2021, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 597, Date 04.09.2019, të Keshillit Te Ministrave" Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike "si dhe Udhezimet,e Ministrise se Shendetesise dhe Mireqenies Sociale per bllokndihmen ekonomike deri 6 %,me fondet e buxhetit qendror dhe vendor,Drejtoria Ekonomike dhe Ceshjeve Sociale:

**PROPOZOJ:**

Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6 %, të fondit të kushtezuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe ato që do trajtohen me fondet e buxhetit vendor , si më poshtë vijon ;

**Kriteret per perfituesit nga programi I bllok-ndihmes 6 % nga fondi I kushtezuar dhe me fondet e buxhetit vendor :**

- ❖ Familjet te cilat kane aplikuar per ndihme ekonomike,brenda tre muajeve dhe nuk jane perzgjedhur fituese nga sistemi i pikezimit.
- ❖ Familjet te cilat perzgjidhen per tu trajtuar me kete fonde duhet te jene te verifikuara paraprakisht nga Administratori shoqeror.
- ❖ Familjet e perzgjedhura duhet te jene familje ne nevoje,pa te ardhura,ose me te ardhura te pamjaftueshme.
- ❖ Familje me Kryefamiljar/e, burra/ gra( vajza nena/ burra baba , te ve/ja, te divorcuar/a),me te pakten nje femije: te mitur, qe ndjek arsimin baze ose te larte.
- ❖ Familje kur K/familjari ose antare te familjes,qe jane te paafte per te punuar ,por per shkak te legjislacionit ne fuqi nuk perfitojne pagesa P.A.K.
- ❖ Femije jetim ne ose nen moshe,te moshuar dhe individe te vetmuar,pa te ardhura ose te ardhura te pamjaftueshme.
- ❖ Familje qe kene femije ne moshe madhore,por qe kane probleme te ndryshme sociale, te cilet kane veshtiresi punesimi.
- ❖ Familje me shume femijë.

Drejtoria Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale,do te propozoje cdo muaj numrin e familjeve per cdo Njesi ne baze te fondit te disponueshem.

**KRYETAR**

Qerim ISMAILAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 260/prot.

Ballsh, më 19.01.2024

**KESHILLIT TE BASHKISE MALLAKASTER**

**RELACION SHPJEGUES PER FAMILJET NE NEVOJE QE DO TE TRAJTOHEN ME NDIHME EKONOMIKE DERI NE 6% TE FONDIT TE KUSHTEZUAR DHE NGA FONDET E BUXHETIT TE BASHKISE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9, neni 24, Ligjit Nr. 9936 date 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" Indryshuar me Ligjin Nr. 109/2017; Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Neni 21 "Roli i Keshillit Bashkiak" Keshilli bashkiak miraton kriteret për dhënie të ndihmës ekonomike për familjet aplikuese që nuk janë shpallur fituese nga sistemi i pikezimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror.

Familjet në nevojë trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtezuar për ndihmën ekonomike, duke përfshirë ose jo dhe fonde të buxhetit vendor, po ju relatojme, kategoritë që do të trajtohen.

Per të ardhur në ndihmë kategorive sociale në kushte ekstremisht në nevojë, pa të ardhura ose të ardhura të pamjaftueshme, të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brenda tre muajve dhe nuk kanë perzgjedhur fitues nga sistemi i pikezimit, hartuam kriteret për trajtimin nga 6% i buxhetit të kushtezuar dhe buxheti i bashkisë me status si vijon:

- ❖ Familje me Kryefamiljar/e, burra/ gra ( vajza, nena/ burra,baba, të ve/ja, të divorcuar/a) me të paktën një fëmijë: të mitur, që ndjek arsimin baze ose të lartë, ndare nga jeta K/familjari ose anetare të familjes.
- ❖ Familje kur K/familjari ose anetare të familjes që janë të paafte për të punuar, por për shkak të Legjislacionit në fuqi nuk përfitojnë pagesa P.A.K, janë familje në varferi ekstreme, të cilat kanë në përberje anetare të paafte për punë.

- ❖ Femije jetim ne ose nen moshe, te moshuar dhe invalide te vetmuar, pa te ardhura ose te ardhura te pamjaftueshme , te cilet nuk perfitojne nga programet e tjera sociale si, pensione etj.
- ❖ Familje qe kane femije ne moshe madhore, por qe kane probleme te ndryshme sociale(perdorues te lendeve narkotike, probleme me ligjin etj) te cilet kane veshtiresi punesimi qe nuk ndodhen ne qendra komunitare.
- ❖ Familje me shume femije, familje qe kane me shume se tre femije, por qe nuk perfitojne nga programet sociale.

Per te gjitha familjet ose individet, zbatohen Udhezimet e Ministrise se Shendetesise dhe Mireqenies Sociale per bllokndihmen ekonomike deri ne 6% si per strukturen e familjes dhe masen e ndihmes ekonomike.

**Ju falenderojme per bashkepunimin.**

**P/S Sherbinit Social**

**Kleidja Hoxhaj**

**Drejtori Ekonomik**

**Aleksander Rama**

**Drejtori Juridik**

**Laureta SALIAJ**

